



Fjalor për gurët në veshka dhe ureter

| | |
|--|---|
| Acidi urik | Një substancë kimike që krijohet kur trupi thyen substancat e quajtura purine. |
| AIJS | Një grup ilaçesh që përdoren për lehtësimin e dhimbjeve. Përdoren shpesh për lehtësimin e dhimbjeve të barkut (kolika renale). |
| Anestezia (e përgjithshme ose lokale) | Para procedurës ju do të merrni ilaçe për të qenë të sigurt që nuk ndjeni dhimbje. Nën anestezinë e përgjithshme ju jeni pa ndjenja dhe jeni të pavetëdijshëm për atë që po ndodh me ju. Nën anestezinë lokale ju nuk do të ndjeni dhimbje në pjesën e trupit ku po bëhet procedura. Anestezia largohet gradualisht pas procedurës. |
| CT pa përmirësim të kontrastit | Lloj i skanerit CT me ekspozim të ulët në rrezatim (<i>shiko gjithashtu</i> Tomografia e kompjuterizuar). |
| Dekompresion | Lehtësimi i presionit në veshka. Tubi i nefrostomisë vendoset drejtpërdrejt në veshka nëpër lëkurë në mënyrë që urina të largohet nga trupi (<i>shih gjithashtu</i> Tubi i nefrostomisë). |
| Endoskopi | Instrument si tub për të ekzaminuar në brendësi të trupit. Mund të jetë fleksibël ose i ngurtë. |
| Fragmentet | Copëzat e gurit të thyera gjatë një procedure. |
| Fshikëza e urinës | Organ që mbledh urinën nga veshkat (<i>shih gjithashtu</i> Veshkat). |
| Gurët asimptomatik | Gurë që nuk shkaktojnë asnjë simptomë. Ata zakonisht zbulohen gjatë testeve të imazherisë që kryhen për një gjendje tjetër. |
| Kalkuloza | Gurët. |
| Kolika renale | Dhimbje e ashpër në ije, mes, baqth apo kofshë e shkaktuar nga një gur që bllokon rrjedhjen normale të urinës. |
| Kundërrindikacion | Një simptomë ose gjendje që e bën të padëshirueshme një mënyrë të caktuar trajtimi. |
| Litotripsia me valë shok (SWL) | Mundësi trajtimi duke thyer gurët në copëza më të vogla duke përdorur valët me energji të lartë. Fragmentet e gurit pas procedurës kalojnë me urinën. |

| | |
|--|---|
| Nefrolitotomia Perkutane (PNL) | Mundësi trajtimi për të hequr gurët drejtpërdrejt nga veshka duke vendosur një tub përmes lëkurës. |
| Oksalate | Një përbërës që gjendet në shumë lloje të ushqimeve të cilat mund të lidhen me formimin e gurëve në veshka apo ureter. |
| Perkutan | Nëpër lëkurë. |
| Sistemi urinar | <i>shih</i> Trakti urinar. |
| Stenti-JJ | Një tub që vendoset përkohësisht në ureter për ta bërë të sigurt rrjedhjen e urinës nga veshka në fshikëzën e urinës. |
| Terapia Mjekësore Përrjashtuese (MET) | Ilaçe që e bëjnë më lehtë dhe me më pak dhimbje kalimin natyral të gurëve. |
| Tomografia e kompjuterizuar (CT) | Teknikë imazherie që bën një seri të imazheve të trupit me rreze X. |
| Trajtimi aktiv | Procedurat për të hequr gurin në veshkë apo ureter. |
| Trajtimi konservativ | Monitorimi i përparimit të sëmundjes së gurit ose trajtimi me ilaçe për të lehtësuar kalimin natyror të tij. |
| Trakti urinar | Sistemi i organeve që prodhon dhe transporton urinën nëpër dhe jashtë trupit. Ai përfshin dy veshkat, dy ureterat, fshikëzën e urinës dhe uretrën. Trakti urinar është i ngjashëm te burrat dhe gratë, vetëm se burrat kanë një uretër më të gjatë. |
| Tubi për nefrostomi | Një tub i vendosur direkt në veshkë përmes lëkurës. Kjo lejon largimin e urinës nga trupi (<i>shih gjithashtu</i> dekompresioni). |
| Ultrasonografia | Teknikë imazherie që përdor tinguj me frekuencë të lartë për të marrë një imazh të brendshëm të trupit. |
| Ultratingulli | <i>shih</i> Ultrasonografia. |
| Ureter | Një nga dy tubat përmes të cilit urina rrjedh nga veshkat në fshikëzën e urinës. |
| Ureteroskopi (e ngurtë ose fleksibël) | Një endoskop që përdoret për traktin urinar. Ai futet në uretër dhe mund të lëvizë nëpër fshikëzën e urinës, deri te ureter, dhe madje edhe në veshka. |
| Ureteroskopia (URS) | Mundësi trajtimi për të hequr gurët në veshka apo ureter. Një ureteroskop futet në traktin urinar nëpërmjet uretrës për të tërhequr gurin (<i>shih gjithashtu</i> Ureteroskopi). |

| | |
|------------------------------|---|
| Uretra | Tubi që mbart urinën nga fshikëza e urinës jashtë trupit. |
| Urografia intravenoze | Teknikë e imazherisë ku agjenti i kontrastit të rrezes X injektohet në venë, zakonisht në krah. |
| Urolitiazë | Sëmundje e gurëve. |
| Urolog | Mjek i specializuar në shëndetin dhe sëmundjet e traktit urinar dhe organeve gjenitale. |
| Veshkat | 2 organe në formë fasule në anën e pasme të barkut që filtojnë gjakun dhe prodhojnë urinë. |
| Vlera e pH | Një madhësi midis 0.0 dhe 14.0 për të përshkruar nëse një lëng është acide apo alkaline. Vlerat e pH pranë 7.0 janë neutrale, çdo gjë mbi të është alkaline, çdo gjë më poshtë është acide. |
| Vlerësimi metabolik | Seri me analiza të gjakut dhe urinës për pacientët të cilët kanë rrezik të lartë të formimit të gurëve. |

Ky informacion për herë të fundit është përditësuar në Qershor 2012.

Kjo fletëpalosje përmban informacione të përgjithshme për gurët në veshka dhe ureter. Nëse keni ndonjë pyetje specifike për gjendjen tuaj individuale mjekësore duhet të konsultoheni me mjekun apo ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor.

Ky informacion është prodhuar nga Shoqata Europiane për Urologji (EAU) në bashkëpunim me Seksionin e EAU për Urolitiazë (EULIS), Seksionin e Urolitiazës të Grupit të Urologëve Akademik të Rinj të EAU, dhe Shoqatën Europiane të Infermierëve për Urologji (EAUN).

Përmbajtja e kësaj fletëpalosjeje është në përputhje me Udhëzimet e EAU.

Bashkëpunëtorë:

| | |
|---------------------------|--------------------------|
| Dr. Thorsten Bach | Hamburg, Gjermani |
| Dr. Murat Binbay | Stamboll, Turqi |
| Ms. Nicola Dickens | Londër, Britani e Madhe |
| Ms. Bente Thoft Jensen | Århus, Danimark |
| Prof. Dr. Thomas Knoll | Sindelfingen, Gjermani |
| Mr. André Mendes | KasteloBranko, Portugali |
| Dr. Francesco Sanguedolce | Barcelonë, Spanjë |
| Dr. Christian Türk | Vjenë, Austri |

Në bashkëpunim me:

